

Njoftim për përqendrim me të cilin NLB Skladi, menaxhim i mjeteve d.o.o. Sllovenia fiton kontrollin mbi GENERALI INVESTMENTS SHA Shkup Maqedonia e Veriut

(lënda nr. 08-169/2023)

Në bazë të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 27.11.2023, te Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin NLB Skladi, menaxhim i mjeteve d.o.o. me seli në Tivolska cesta 48, 1000 Lubjanë, Slloveni, synon të fitojë kontroll të pavarur drejtpërdrejt mbi Shoqërinë për menaxhimin e fondeve të hapura dhe të mbyllura investive GENERALI INVESTMENTS SHA Shkup, me seli në bul. Partizanski Odredi nr. 14A/1-2, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut me anë të shitblerjes së aksioneve.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Aktiviteti prioritar i regjistruar i NLB Skladi është menaxhimi i fondeve financiare.

NLB Sklady është pjesë e Grupit NLB. Në Maqedoninë e Veriut, Grupi NLB ka dy shoqëri të lidhura të regjistruara:

- (1) NLB Bank AD Shkup, me seli në ul. Vodnjanska nr. 1, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitet prioritar të regjistruar 06.1 – bankë; dhe
- (2) Shoqëria e lizingut NLB LEASE&GO SHPK Shkup me seli të regjistruar në rr. Vodnjanska Nr. 1, 1000 Shkup, Maqedonia e Veriut, me aktivitetin prioritar të regjistruar 64.91 – Lizing Financiar dhe 77.11 Marrja me qira dhe dhënia me qira (Lizing) e makinave dhe mjeteve motorike të kategorisë së lehtë.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se tregu relevant i mallrave për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si shërbime që kanë të bëjnë me aktivitetet e menaxhimit të fondeve investive, ndërsa shtrirja gjeografike e tregut është nacional ose treg i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

01.12.2023

Shkup